



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN Znj. ORNELA RRUMBULLAKU

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 12.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurores Ornela Rrumbullaku, e cila është e caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe prej një viti është e komanduar si Këshilltare pranë KLP dhe ka rishfaqur vullnetin për t’u komanduar përsëri në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Ornela Rrumbullaku ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 2006, pasi me dekretin nr. 5053, datë 04.10.2006 të Presidentit të Republikës, është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nga dosja personale rezulton se ka patur disa transferime si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Kavajë si dhe ka patur pozicion Drejtuesi nga viti 2013 deri më 2014 për rreth 1 vit në Prokurorinë e Kavajës. Znj. Rrumbullaku ka një eksperiencë profesionale në punë si prokuror rreth 14 vjet, nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar, aktualisht është e komanduar prej 1 viti si Këshilltare pranë Këshillit dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr.703/1 datë 21.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë rezulton se nisur nga ngarkesa në punë në këtë Prokurori, komandimi i saj pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë së Kavajës.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i znj. Ornela Rrumbullaku në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë së Kavajës dhe nuk cenohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror Znj. Ornela Rrumbullaku.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020